



Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva



KUVENDI I KOMUNËS

Në bazë të neneve 11, 12.2 shkronja d) ndërlidhur me nenin 40.2 shkronja d) të Ligjit për vetëqeverisjen lokale nr.03/L-040, neneve 14 dhe 15 ndërlidhur me nenin 34 paragrafi 2.4 të Statutit të Komunës së Podujevës, nr.prot.01-020/01-0050862/18, si dhe nenin 88 të Rregullores së Punës së Kuvendit nr.01/146-11 të datës 29 prill 2010, në procedurën e rishqyrtimit sipas rekomandimeve të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal përmes Shkresës nr.prot.020-108/3 datë 21.02.2024, Kuvendi i Komunës së Podujevës, në mbledhjen e mbajtur më 04 mars 2024, miratoi këtë,

V E N D I M PËR CAKTIMIN E ORARIT TË MBLEDHJEVE TË KUVENDIT TË KOMUNËS SË PODUJEVËS PËR VITIN 2024

Neni 1

Me këtë vendim caktohet orari i mbledhjeve të rregullta të Kuvendit të Komunës së Podujevës për vitin 2024, si në vijim:

- Mbledhja e muajit Shkurt më datë;.....29 shkurt 2024
- Mbledhja e muajit Mars më datë;.....28 mars 2024
- Mbledhja e muajit Prill më datë;.....30 prill 2024
- Mbledhja e muajit Maj më datë;.....31 maj 2024
- Mbledhja e muajit Qershor më datë;.....27 qershor 2024
- Mbledhja e muajit Korrik më datë;.....30 korrik 2024
- Muaji Gusht;..... pushim, përveç paraqitjes së ndonjë kërkesë të veçantë për mbajtje të mbledhjes.
- Mbledhjet e muajit Shtator më;.....02 shtator 2024 dhe 27 shtator 2024
- Mbledhja e muajit Tetor më datë;.....28 tetor 2024
- Mbledhja e muajit Nëntor më datë;.....26 nëntor 2024
- Mbledhja e muajit Dhjetor më datë;.....27 dhjetor 2024

Neni 2

Para çdo mbledhje të Kuvendit të Komunës sipas këtij vendimi, Komiteti për Politikë dhe Financa paraprakisht mban mbledhje ku shqyrton dhe rekomandon pikat e rendit të ditës.

Neni 3

Pavarësisht këtij vendimi, Kuvendi i Komunës mund të mbaj edhe mbledhje tjera të cilat parashihen me legjislacionin në fuqi, si mbledhje solemne, të jashtëzakonshme, urgjente dhe mbledhje tjera sipas situatave të paraqitura.

Neni 4

Datat e mbajtjes së mbledhjeve të Kuvendit sipas këtij vendimi, mund të lëvizin më së shumti 7 ditë para ose pas, nga planifikimet në nenin 1.

Neni 5

Vendimi hynë në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në Zyrën e protokollit të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal si dhe 7 ditë pas publikimit në ueb faqen zyrtare të Komunës, përkatësisht konform nenit 81 të Ligjit për vetëqeverisje lokale nr.03/L-040, dhe nenit 9 paragrafi 8 të rregullores (QRK) nr.10/2019 për shqyrtimin administrativ të akteve të komunave, me plotësim ndryshimet e bëra me Rregulloren nr.06/2021.

Nr.Prot. 01-016/01-0015829/24
Podujevë, datë; 04 mars 2024

